

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-17728/25 dt. 04.02.2025, të pronarëve Bashkim Sahiti, Zeqir Salihi, Jehona Beqiri, Arsim Sahiti, Muharrem Salihi, Musa Vitija, Rexhep Vitija, Avdush Vitija dhe Ismet Vitija nga Prishtina dhe investitorit “Butrinti Building” Sh.p.k. me adresë rr. “Ferd Curri”, Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, “Ndërtesa 1” me etazhitet B+P+5ET, “Ndërtesa 2” me e etazhitet B+P+5ET, “Ndërtesa 3” me etazhitet B+P+5ET dhe “Ndërtesa 4” me etazhitet B+P+5ET, ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Zona Ekonomike” dhe të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, në rrugën “Qamil Olluri”, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 20.05.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Bashkim Sahiti, Zeqir Salihi, Jehona Beqiri, Arsim Sahiti, Muharrem Salihi, Musa Vitija, Rexhep Vitija, Avdush Vitija dhe Ismet Vitija nga Prishtina dhe investitorit “Butrinti Building” Sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit ARBK 8111299488, me përfaqësues Shkumbin Zhegrova, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-17728/25 dt. 04.02.2025, përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emëtuara si, “Ndërtesa 1” me etazhitet B+P+5ET, “Ndërtesa 2” me e etazhitet B+P+5ET, “Ndërtesa 3” me etazhitet B+P+5ET dhe “Ndërtesa 4” me etazhitet B+P+5ET, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-144671/21 dt. 07.03.2022, në kuadër të bllokut urban “ZM-07”, të tërësisë “ZM”, të Planit Rregullues “Zona Ekonomike” dhe të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10408-0, ZK Prishtinë (në bashkë pronësi të Ismet Gashi, Bashkim Sahiti, Zeqir Salihi, Jehona Beqiri, Arsim Sahiti, Muharrem Salihi, Musa Vitija, Rexhep Vitija, Avdush Vitija dhe Ismet Vitija nga Prishtina).

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Qamil Olluri” ku janë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 10, 12, 14, 16, 18, 20, 22, 24, 26, 28, 30, 32, 34, 36, 38, 40, 42, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 56, 58, 60, 62, 64 dhe 66 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Arsyetim

Pronarët Bashkim Sahiti, Zeqir Salihi, Jehona Beqiri, Arsim Sahiti, Muharrem Salihi, Musa Vitija, Rexhep Vitija, Avdush Vitija dhe Ismet Vitija nga Prishtina dhe investitorit "Butrinti Building" Sh.p.k., me certifikatë të regjistrimit ARBK 8111299488, me përfaqësues Shkumbin Zhegrova, me kërkesën me 05 Nr.391/02-17728/25 dt. 04.02.2025, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuara, "Ndërtesa 1" me etazhitet B+P+5ET, "Ndërtesa 2" me etazhitet B+P+5ET, "Ndërtesa 3" me etazhitet B+P+5ET dhe "Ndërtesa 4" me etazhitet B+P+5ET, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10408-0, ZK Prishtinë (në bashkë pronësi të Ismet Gashi, Bashkim Sahiti, Zeqir Salihi, Jehona Beqiri, Arsim Sahiti, Muharrem Salihi, Musa Vitija, Rexhep Vitija, Avdush Vitija dhe Ismet Vitija nga Prishtina), ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-144671/21 dt. 07.03.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-99065/24 dt. 27.12.2025,

ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Bashkim Koliqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Arba Shushka; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Herolinde Dautaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Besart Osmanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Berat Hasanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Vehbi Avdullahaj; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Berat Hasanaj, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale "Geo Group" me nr. të licencës 52;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat

nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuar-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-së

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-17728/25 DT. 20.05.2025**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

